

Në përputhje me nenin 24 paragrafi (1) alineja 3 dhe në lidhje me nenin 83 paragrafi (2) të Ligjit për Komunikime Elektronike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 135/2025 dhe 269/2025), dhe në përputhje me Marrëveshjen për uljen e çmimit të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor, të nënshkruar më 04.04. të vitit 2019 midis ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike: Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Serbisë dhe Kosova (në tekstin e mëtejshëm vetëm Marrëveshje), drejtori i Agjencisë për Komunikime Elektronike (në tekstin e mëtejshëm Agjencia) më 06.07. të vitit 2026 miratoi:

## V E N D I M

### për përcaktimin e çmimeve maksimale të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular

#### I

Operatorëve që posedojnë rrjete publike të komunikimit celular dhe ofrojnë shërbime publike të komunikimit celular në Republikën e Maqedonisë së Veriut u përcaktohen kushtet e mëposhtme dhe çmimet maksimale për shërbimet që ata i ofrojnë në roaming:

#### a) Çmimet maksimale të shitjes me pakicë të shërbimeve të roamingut në rajonin e Ballkanit Perëndimor (pa TVSH)

1. Nga 1 korriku i vitit 2021, operatorët e rrjeteve publike të komunikimit celular në Republikën e Maqedonisë së Veriut për shërbimet e roamingut nuk mund të zbatojnë kompensime shtesë për çmimet vendore të shitjes me pakicë për sigurimin e shërbimeve të rregulluara të shitjes me pakicë në roaming.
2. Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit celular në Republikën e Maqedonisë së Veriut për shërbimet e roamingut mund të zbatojnë politika të përdorimit të drejtë në lidhje me shpenzimet e shërbimeve të rregulluara të roamingut të shitjes me pakicë me çmime të barabarta me çmimet vendore të shitjes me pakicë, në mënyrë që të mbrohen nga abuzimi dhe përdorimi i pazakontë i shërbimeve të rregulluara të shitjes me pakicë në roaming, në përputhje me Rregulloren me të cilën përcaktohet mënyra e vlerësimit të papagueshmërisë dhe paqëndrueshmërisë ekonomike në punën e operatorëve nga sigurimi i shërbimeve të roamingut, mënyra e parashtrimit të kërkesës për rritjen e çmimeve të shitjeve me pakicë të shërbimeve të roamingut, si dhe politikat e përdorimit të drejtë” (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja për Përdorim të Drejtë”.
3. Në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, që synojnë të sigurojnë qëndrueshmërinë e modelit vendor të arkëtimit të shitjes me pakicë, nëse operatori që siguron shërbime të rregulluara të shitjes me pakicë në roaming nuk mund të kthejë kostot totale reale dhe të projektuara nga sigurimi i shërbimeve të rregulluara të roamingut në përputhje me pikën I, nën-pikën (a), paragrafët 1 dhe 2 të këtij Vëndimi, nga të ardhurat totale reale dhe të projektuara nga sigurimi i

këtyre shërbimeve, atëherë operatori mund të kërkojë nga Agjencia aprovim për imponimin e kompensimit shtesë për shërbimet e rregulluara të shitjes me pakicë në roaming. Ky kompensim shtesë duhet të zbatohet vetëm deri në atë shkallë që është e domosdoshme për të kthyer kostot nga sigurimi i shërbimeve të rregulluara të shitjes me pakicë në roaming, duke marrë parasysh kompensimet maksimale të zbatueshme të shitjes me shumicë në përputhje me pikën I, nënpika (b) të këtij vendimi.

4. Parashtrimi i kërkesës për zbatimin e kompensimit shtesë për shërbimet e rregulluara të shitjes me pakicë në roaming, afatet dhe përmbajtja e tyre, si dhe zbatimi dhe metodologjia për vlerësimin e qëndrueshmërisë së heqjes së tarifave të kompensimeve të shitjes me pakicë për roamingun janë përcaktuar në „Rregulloren për Përdorimin e Drejtë”.
5. Nëse, për këtë trafik që tejkalon kufirin e përcaktuar në përputhje me politikat e përdorimit të drejtë të përcaktuara në përputhje me „Rregulloren e Përdorimit të Drejtë”, operatori zbaton kompensime shtesë për çmimet vendore të shitjes me pakicë për sigurimin e shërbimeve të rregulluara të shitjes me pakicë në roaming, atëherë operatori duhet t'i përmbahet si vijon (pa TVSH):
  - Kompensimi shtesë për thirrjet e rregulluara dalëse, mesazhet dalëse SMS dhe shërbimet e bartjes së të dhënave në roaming nuk duhet të tejkalojë çmimet e shitjes me shumicë të shërbimeve të rregulluara në roaming në rajonin e Ballkanit Perëndimor pika I, nënpika b), paragrafi 1 i këtij Vendimi,
  - Shuma e çmimit vendor të shitjes me pakicë dhe tarifës shtesë që imponohet për thirrjet e rregulluara dalëse, mesazhet dalëse SMS dhe shërbimet e bartjes së të dhënave në roaming nuk duhet të kalojë 0,19 euro/minutë, 0,06 euro/SMS dhe 0,18 euro/MB adekuate,
  - Kompensimi shtesë për thirrjet e rregulluara dalëse në roaming nuk duhet të tejkalojë çmimin maksimal të shitjes me shumicë për përfundimin e thirrjes në rrjetet celulare të thirrjeve të rregulluara në roaming me origjinë dhe që përfundojnë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në përputhje me pikën I, nënpikën c), paragrafi 1 të këtij Vendimi.
6. Operatorët nuk do të zbatojnë kurrfarë kompensimesh shtesë për mesazhet hyrëse SMS të rregulluara në roaming ose për mesazhet hyrëse për postë zanore në roaming. Kjo nuk vlen për tarifat e shërbimeve të tjera, të tilla si ato për dëgjimin e mesazheve të tilla.
7. Arkëtimi shtesë i kompensimit për rregullimin e thirrjeve dalëse ose hyrëse në roaming duhet të tarifohet për sekondë. Operatori mund të zbazojë periudhë minimale fillestare të arkëtimit që nuk tejkalon 30 sekonda për thirrjet e rregulluara dalëse në roaming. Arkëtimi i tarifës shtesë për shërbimet e rregulluara për bartjen e të dhënave në roaming duhet të bëhet në bazë të kilobajtit, me përjashtim të mesazheve MMS, ku baza për arkëtim mund të jetë për njësi. Në këtë rast, kompensimi që operatori mund t'i arkëtojë parapaguesit për transmetimin ose marrjen e mesazhit MMS në roaming nuk duhet të tejkalojë çmimin maksimal të rregulluar të shitjes me pakicë për bartjen e të dhënave.
8. Përdoruesit e roamingut nuk duhet të përjashtohen nga mundësia e përdorimit të ofertave të operatorëve ku për kompensime ditore ose fikse periodike janë përfshirë vëllim i caktuar i shërbimeve të roamingut me kusht që në vëllimin e plotë të konsumuar të këtyre ofertave çmimi për njësi për thirrjet e bëra të rregulluara, SMS-të e dërguara dhe shërbimet e bartjes së të

dhënave në roaming të mos tejkalojnë çmimin përkatës vendor të shitjes me pakicë dhe tarifën maksimale shtesë siç është përcaktuar në paragrafin 5 alineja 2 e kësaj nënpike.

9. Operatorët mund të ofrojnë, ndërsa parapaguesit mund të pranojnë çmime për shërbime të roamingut të ndryshme nga ato të shërbimeve të rregulluara të shitjes me pakicë në roamng të përcaktuara në pikën I, nënpike (a), paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij Vendimi. Në këtë rast, operatori duhet të informojë parapaguesin për avantazhet e përdorimit të këtyre çmimeve për shërbimet roaming si dhe mundësitë që ai nuk do të përdorë nëse do të përdorte shërbimet roaming me çmime të rregulluara.

Operatorët duhet t'i zbatojnë çmimet e shërbimeve të rregulluara të shitjes me pakicë në roaming të përcaktuara në pikën I, nënpike (a), paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij Vendimi për të gjithë parapaguesit ekzistues dhe të rinj.

Parapaguesi mund të kërkojë në çdo kohë të kalojë midis çmimeve të ndryshme të shërbimeve të rregulluara të roamingut, atyre të përcaktuara në pikën I, nënpike (a), paragrafët 1, 2 dhe 3 dhe atyre të përcaktuara në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi të këtij Vendimi. Operatori do ta bëjë këtë kalim brenda një dite pune nga pranimi i kërkesës së parapaguesit, pa kompensim, dhe nuk duhet të shkaktojë asnjë kushtëzim ose kufizime për elementët tjerë të parapagimit përveç në pjesën e roamingut. Parapaguesi ka të drejtë të bëjë kalim ndërmjet çmimeve të ndryshme për shërbimet e rregulluara të roamingut më së shumti një herë në dy muaj.

10. Për thirrjet e rregulluara në roaming nuk do të arkëtohet kompensim për vendosjen e thirrjes. Nëse ka kompensim për vendosjen e thirrjes në tarifata brendshme të shitjes me pakicë, ky kompensim nuk do të arkëtohet në çmimet e rregulluara të shitjes me pakicë në roaming.

**b) Çmimet maksimale mesatare të shitjes me shumicë të shërbimeve të rregulluara të roamingut në rajonin e Ballkanit Perëndimor (pa TVSH)**

1. Nga 1 korriku 2021, çmimi mesatar maksimal të shitjes me shumicë për shërbimet e rregulluara të roamingut që operatori mund ta arkëtojë është dhënë në Tabelën 1 (pa TVSH).

**Tabela 1**

Shërbimi	çmimi (01.07.2021- 31.12.2021)	çmimi (01.01.2022- 31.12.2022)	çmimi (01.01.2023- 31.12.2023)	çmimi (01.01.2024- 31.12.2024)	çmimi (01.01.2025- 31.12.2025)	çmimi (01.01.2026- tutje)
Thirrje e rregulluar dalëse në roaming	0.032 € /min					
Mesazh i rregulluar dalës SMS në roaming	0.01 € /SMS					
Shërbimet e rregulluara për bartjen e të	0.0077 €/MB	0.006 €/MB	0.0045 €/MB	0.0035 €/MB	0.003 €/MB	0.0025 €/MB

<b>dhënave në roaming</b>						
---------------------------	--	--	--	--	--	--

2. Çmimet mesatare të shitjes me shumicë zbatohen midis dy operatorëve dhe llogariten për një periudhë prej 12 muajsh ose çdo periudhë më të shkurtër që mund të mbetet para skadimit të periudhës së zbatimit të çmimit mesatar maksimal të shitjes me shumicë.
3. Çmimi mesatar maksimal i shitjes me shumicë duhet të përfshijë koston e fillimit, transitit dhe ardhurat totale me shumicë nga thirrjet roaming të rregulluara me numrin e përgjithshëm të thirrjeve roaming me shumicë të shprehura në minuta që aktualisht përdoren për të ofruar thirrjet roaming me shumicë brenda vendeve nënshkruese të Marrëveshjes nga operatori relevant në periudhën relevante, të grumbulluara për sekondë dhe të rregulluara në mënyrë që të merret parasysh mundësia e zbatimit të një periudhe minimale fillestare të arkëtimit që nuk mund të jetë më e gjatë se 30 sekonda.
4. Çmimi mesatar me shumicë për mesazhet SMS llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat totale të shitjes me shumicë nga mesazhet SMS të rregulluara të roamingut të filluara dhe të transmetuara brenda vendeve nënshkruese të Marrëveshjes nga operatori relevant në periudhën relevante, me numrin e përgjithshëm të mesazheve SMS të filluara dhe të transmetuara në periudhën e njëjtë.
5. Operatori nuk do të arkëtojë kompensim të shitjes me shumicë për përfundimin e mesazheve të rregulluara SMS në roaming që janë iniciuar brenda vendeve nënshkruese të Marrëveshjes.
6. Çmimi mesatar i shitjes me shumicë të transferimit të të dhënave llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat totale të shitjes me shumicë nga ofrimi i shërbimeve të rregulluara të transferimit të të dhënave roaming me sasinë totale të të dhënave të shprehura në megabajt që janë shfrytëzuar me të vërtetë për të siguruar këtë shërbim brenda vendeve nënshkruese të Marrëveshjes nga operatori relevant në periudhën relevante, të grumbulluara për kilobajt.

**e) Çmimet maksimale të shitjes me shumicë për përfundimin e thirrjeve në rrjetet celulare të thirrjeve të rregulluara në roaming me origjinë dhe përfundim në rajonin e Ballkanit Perëndimor (pa TVSH)**

1. Nga 1 korriku 2021, çmimi maksimal i shitjes me shumicë të shërbimeve të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare për thirrjet e rregulluara në roaming me origjinë dhe përfundim brenda vendeve nënshkruese të Marrëveshjes janë paraqitur në Tabelën 2. (pa TVSH).

**Tabela 2**

<b>shërbimi</b>	<b>Çmimi (01.07.2021 - tutje)</b>
<b>Përfundimi i thirrjes në rrjetet celulare</b>	€ 0.016/min

2. Çmimet e përfundimit të thirrjeve në rrjetet celulare për thirrjet e rregulluara në roaming llogariten duke pjesëtuar të ardhurat totale të shitjes me shumicë të përfundimit të thirrjeve në rrjetet celulare me numrin e përgjithshëm të minutave të thirrjeve të përfunduara në rrjetin celular që përdoren me të vërtetë për të siguruar thirrje të rregulluara në roaming me origjinë dhe që përfundojnë brenda vendeve nënshkruese të Marrëveshjes nga operatori relevant në periudhën relevante, të grumbulluara për sekondë.

## II

Çmimet për shërbimet me pakicë në roaming të përcaktuara me këtë vendim të shprehur në denarë pa TVSH do të llogariten me kursin mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut të publikuar më 01 qershor të vitit rrjedhës.

## III

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe shpallet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Komunikime Elektronike.

## Arsyetim

Në nenin 83 të Ligjit për Komunikime Elektronike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 135/2025 dhe 269/2025) është parashikuar se Agjencia ka të drejtë të përcaktojë çmimet maksimale të shërbimeve që ata ofrojnë në roaming për përdoruesit nga vendet me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje, memorandum, kontratë ose protokoll për uljen e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular, në baza reciproke, të cilat nuk mund të jenë më të larta se çmimet e shërbimeve të njëjtave që zbatohen midis vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Në nenin e njëjtë është parashikuar se Agjencia ka të drejtë të përcaktojë çmimet maksimale të shitjes me shumicë të shërbimeve për përfundimin e thirrjeve ndërkombëtare nga vendet me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje, memorandum, kontratë ose protokoll për të njëjtën, në baza reciproke.

Marrëveshja për uljen e çmimit të shërbimeve të roamingut në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor është lidhur më 04.04. të vitit 2019 në Beograd midis ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike: Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Serbisë dhe Kosova.

Në përputhje me nenin 4 të Marrëveshjes, organet rregullatore për komunikimet elektronike në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të jenë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të së njëjtës Marrëveshje, duke përfshirë rregullimin e normave të përfundimit të thirrjeve në rrjetet celulare të thirrjeve të rregulluara në roaming me origjinë dhe përfundim në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Duke marrë parasysh këtë, e në përputhje me nenin 24 paragrafi (1) alineja (3) dhe nenin 83 të Ligjit për Komunikime Elektronike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 135/2025 dhe 269/2025), e në përputhje me Marrëveshjen për uljen e çmimit të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor të nënshkruar më 04.04. të vitit 2019 midis ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike: Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe

Hercegovina, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Serbisë dhe Kosova, drejtori i Agjencisë për Komunikime Elektronike miratoi Vendim si në dispozitivin.


KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

udhëheqës i njësisë për analizë të tregjeve :  
Aleksandar Kocevski

udhëheqëse e njësisë për përcaktimin e detyrimeve rregullatore:  
Vaska Petroviq

udhëheqëse e sektorit për rregullativë:  
Kristina Bozhinovska

përkthim: Challenge  
kontrollor: udhëheqëse e njësisë për përkthim  
Monika Mladnoviq



Përpiluar në Agjencinë për Komunikime Elektronike  
Numri ynë: 1308-1786/1  
Shkup, viti 06.02.2016